

VENDIM
Nr. 535, datë 22.9.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES *ISTISNA'A* DHE MARRËVESHJES SË
AGJENCISË *ISTISNA'A*, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM, NË
LIDHJE ME NDËRTIMIN E SEKSIONIT QUKËS-QAFËPILLOÇË, TË
KORRIDORIT RRUGOR TIRANË-KORÇË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.
128/2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes *Istisna'a* dhe marrëveshjes së Agjencisë *Istisna'a*, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, në lidhje me ndërtimin e seksionit Qukës-Qafëpilloçë, të korridorit rrugor Tiranë-Korçë, të ratifikuar me ligjin nr. 128/2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE
Arben Ahmetaj**



Grupi i Bankës Islamike për Zhvillim
Qendra Rajonale, Turqi

RHTR/1803

22.4.2021 G

Për Zyrën e:
Sh. së SAJ Znj. Anila Denaj
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Për Zyrën e:
Ministria e Shtetit për Rindërtim
(Zyra e Guvernatorit të Bankës Islamike për Zhvillim për
Shqipërinë),
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Faks: +355 4 222 8405

Sekretariati.Rindertim@kryeministria.al

Për dëjnen: Zyrës së:
Sh. sëSAJ Znj. Belinda Balluku
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Për dëjnen: Z. Ergys Verdho
Drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti Rrugor Shqiptar
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Faks: +355 4 2232 389

Faks: + 355 4 2223 600

Lënda: Ndërtimi i Segmentit Qukës-Qafë Plloçë si pjesë e Korridorit Rrugor Tiranë-Korçë (ALB0036) – Miratimi i Bankës Islamike për Zhvillim (BIZH) për Shtyrjen e dytë të Datës së Fundit të Disbursimit (CDD) dhe Periudhës së Realizimit (GP).

Lutemi referojuni shkresës së Sh. së Saj. Ministres së Financave dhe Ekonomisë, të datës 24 mars 2021, në të cilën Bankës Islamike për Zhvillim (BIZH) i kërkohet të shtyjë datën e mbylljes së Disbursimit (CDD/GP) deri më 31 mars 2023.

Bazuar në kërkesën e Qeverisë, menaxhimi i BIZH mori parasysh sa vijon:

- subjekti i projektit është 8.16 vjet (nga miratimi në shkurt 2013) që është më i lartë se objektivi i moshës së portofolit mesatar të pragut 5.9 vjet,
- projekti tashmë ka arritur 90% progres fizik (në fushën fillestare) dhe shtyrja duhet të jetë në përpjesëtim me aktivitetet e mbetura prej 10% në kuadër të projektit, dhe
- mbajtja e projektit e hapur për një periudhë më të gjatë sesa nevojitet do të rrisë në mënyrë të panevojshme shumat e konsiderueshme tashmë të disbursuara

Rrjedhimisht, në funksion të sa më sipër, menaxhimi i BIZH ka aprovuar shtyrjen që kërkon përfundimin e të gjitha aktivitetëve të mbetura të projektit deri më 30 shtator 2021, për të mundësuar arritjen e mbylljes financiare të projektit deri në dhjetor 2021. Ju lutem vëreni se kjo

*Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service*

është shtyrja përfundimtare e CDD / GPB në kuadër të projektit dhe asnjë zgjatje e mëtejshme në CDD / GP e projektit nuk do të vlerësohet.

Ju lutem njoftoni Agjencinë Ekzekutive të Projektit të zgjidhë të gjitha çështjet teknike me të cilat është përballur projekti dhe të përfundojë aktivitetet e mbetura brenda kësaj periudhe.

BIZH pret për përfundimin e suksesshëm dhe në kohë të Projektit.

Me respekt,

*Nënshkrimi
Hammad Hundi
Zyrtari i Ngarkuar*